



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**UP1. Numër 0803-59**  
**04.03.2024**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.0803-59 datë 16.02.2024 dhe Propozimin PA1 nr.0803-59 datë 29.02.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.0201-1054/9 datë 01.03.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, miratoi:

**AKTVENDIM**  
**për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen**  
**e lejes për transmetim televiziv**

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN – LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08-44 datë 07.09.2023.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 6-të mbajtur më 19.02.2024, me Konkluzion ark.nr.0201-773/8 datë 19.02.2024, miratoi propozimin e mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, PA1 nr.0803-59 datë 16.02.2024 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN – LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08-44 datë 07.09.2023, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.0503-783/1 datë 16.02.2024, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 21.02.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.0803-59 datë 21.02.2024, për njoftim se nëse nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.



**Агенција за аудио и  
аудиовизуелни  
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38**  
**1000 Скопје**  
**Република Северна**  
**Македонија**

**Тел. + 389 2 3103 400**

**[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)**  
**[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)**  
**[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)**





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

Megjithatë, më 28.02.2024 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për Financa dhe Logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.0503-783/2 datë 28.02.2024, se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN – LD SHPKNJP Koçan, më 27.02.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 107.086,00 (njëqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) denarë, me të cilën kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv e pagoi në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.0803-59 datë 16.02.2024 dhe Propozimin PA1 nr.0803-59 datë 29.02.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.0201-1054/9 datë 01.03.2024, Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër është marrë aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuele**  
**Kryetari i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

---

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).